



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1305 prot.

Roskovec, më 18.02.2023

**VENDIM**

Nr. 19, datë 27.02.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES DHE PJESËMARRJEN E BASHKISË ROSKOVEC  
NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E  
SHËRBIMEVE TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE**

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës; të nenit 9 dhe pikës 1 dhe 5 të nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 69, datë 30.09.2022 “Për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec, për negociimin me bashkitë e Qarkut Fier për marrjen në dorëzim të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier, sipas detyrimeve të kontratës koncensionare”; Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier lidhur ndërmjet Bashkisë Roskovec dhe Bashkive Fier, Patos, Lushnjë, Divjakë dhe Mallakastër, pasi shqyrtoi përmbajtjen dhe kushtet e parashtruara në marrëveshje me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

1. Miratimin e Marrëveshjes protokolluar pranë Bashkisë Roskovec me Nr. 10096, datë 14.11.2022 “Për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Trajtimit të Mbetjeve”, me emër subjekti “Shoqëria e Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier”sh.a lidhur ndërmjet Bashkisë Roskovec dhe Bashkive Fier, Patos, Lushnjë, Divjakë dhe Mallakastër.
2. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, Drejtoria Ekonomike dhe Ndërmarrja e Pastrim, Gjellbërim dhe Mirëmbajtje Varreza me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**  
**Kadri Hyska**